

P. Pustina

PROKURORIA E PËRGJITHSHME  
Nr. 68/13 Prot.  
Datë 01.03.2021  
DREJTORIA TABELI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
LUSHNJË

Nr. 1547 Prot.

Lushnje, më 25.02.2021

Lënda: Dërgojmë Anlizën vjetore 2020

Drejtuar: PROKURORISË SË PËRGJITHSHME

PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM  
Z. OLSIAN ÇELA

I nderuar z.Prokuror i Përgjithëshëm:  
Bashkëlidhur kësaj shkrese po ju dërgojmë analizën vjetore 2020, të punës së  
Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje.

Duke Ju falenderuar për bashkëpunimin

DREJTUESI PROKURORISË  
ARBEN DYLA



Z. Skahu  
25.02.2021



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**PROKURORIA PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
LUSHNJE**

**ANALIZË**

**E TREGUESVE KRYESORË TË PUNËS PËR VITIN 2020,  
TË PROKURORISË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË  
LUSHNJE**

**DREJTUAR**

**PROKURORIT TË PËRGJITHSHËM  
Z. OLSIAN ÇELA**

**I nderuar z. Prokuror i Përgjithshëm!**

Në mbyllje të vitit 2020 në zbatim të nenin 50 pika 2 të Ligjit Nr.97/2016 “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në R.Sh” nëpërmjet këtij materiali Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje paraqet arritjet dhe objektivat e realizuar gjatë ushtrimit të ndjekjes penale si në fazën e hetimit paraprak dhe në gjykim, kryerjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në ligj nga prokurorët dhe oficerët e policisë gjyqësore si dhe analizon treguesit sasiorë dhe cilësorë në përgjithësi dhe në veçanti për secilin prej tyre.

Në fokusin e punës së Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje gjatë këtij viti nuk janë trajtuar me përparësi vetëm çështjet më problematike që shqetësojnë komunitetin e këtij rrethi, si: veprat penale kundër jetës e shëndetit e më në veçanti veprat penale për dhunën në familje, veprat penale kundër pasurisë, veprat penale kundër veprimtarisë shtetërore të kryera nga nëpunësit shtetërorë, por edhe për veprat penale ndjekja penale e të cilave është përcaktuara si prioritare në “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave” të miratuara me vendimin Nr.501 date 24.06.2020, në luftë kundër kriminalitetit për vitin 2020.

Në këtë kuadër, duke zbatuar detyrimin kushtetues si autoriteti i vetëm për ushtrimin e ndjekjes penale, kemi qenë të angazhuar për të kryer një hetim sa më të plotë dhe të gjithanshëm për të gjitha procedimet e trajtuara gjatë këtij viti, për të ngritur dhe përfaqësuar sa më mirë

akuzën në gjykim, për të ekzekutuar në kohë vendimet penale të gjykatave dhe për të mbikqyrur në vazhdimësi vuajtjen e dënimit të të dënuarve.


Për zbatimin e rekomandimeve prioritare të KM për vitin 2020 si dhe Planit të Veprimit të miratuar me URDHËRIN Nr.112 datë 27.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm për zbatimin e të cilit ka dalë “Udhezimi i Përgjithshëm” Nr.11 datë 20.07.2020 i Prokurorit të Përgjithshëm, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje ka hartuar “Planin e Veprimit” të miratuar me Urdhërin Nr.6 datë 25.09.2020 dhe nga Drejtuesi i Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje është nxjerre Udhezimi e Përgjithshëm Nr.6 datë 25.09.2020 për zbatimin e “Panit të Veprimit” për zbatimin e rekomandimeve prioritare të KM për vitin 2020

Mëposhtë po paraqesim në mënyrë analitike treguesit e përgjithshëm të ngarkesës së punës për vitin 2020 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje


### VOLUMI I PUNËS NË HETIM GJATË VITIT 2020

|      | Mbartur   |           |                   |             |                | Regjistruar |           |                   |             |                | Rifilluar |                   |             |                |
|------|-----------|-----------|-------------------|-------------|----------------|-------------|-----------|-------------------|-------------|----------------|-----------|-------------------|-------------|----------------|
|      | Procedime | Kallëzime | Persona nën hetim | Të pandehur | Arrest në burg | Kallëzime   | Procedime | Persona nën hetim | Të pandehur | Arrest në burg | Procedime | Persona nën hetim | Të pandehur | Arrest në burg |
| 2018 | 202       | 38        | 38                | 117         | 26             | 1420        | 865       | 115               | 257         | 60             | 15        | 2                 | 3           | -              |
| 2019 | 222       | 18        | 31                | 61          | 15             | 1549        | 869       | 136               | 278         | 60             | 17        | 2                 | -           | -              |
| 2020 | 315       | 29        | 48                | 94          | 23             | 1299        | 732       | 147               | 201         | 51             | 7         | -                 | -           | -              |

Në mënyrë grafike përhapja e veprave penale në rrethin e Lushnjes gjatë vitit 2020:



Konkretisht, figurat e veprave penale më të përhapura gjatë vitit 2020 janë si më poshtë:



Siç rezulton nga sa mësipër, veprat penale më të përhapura në rrethin e Lushnjes kanë qenë:

- “Vjedhja” e parashikuar nga neni 134 i K.Penal (249 procedime);
- “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.Penal (109 procedime),
- “Dhuna në familje” e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal (56 procedime);
- “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a i K.Penal (45 procedime),
- “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” e parashikuar nga neni 283 i K.Penal (30 procedime),
- “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” e parashikuar nga neni 290 i K.Penal (27 procedime), etj.

Ndërsa referuar volumit total të punës që ka përballuar Prokurorira pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje në krahasim me vitin 2019 rezulton se: Gjatë vitit 2020 vërehet një pakësim i numrit të kallëzimeve dhe procedimeve të regjistruara, dhe në vlersimin tonë kjo ka

ardhur edhe për shkak të kufizimit të lëvizjes së popullsisë për shkak të gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga virusi Covid-19.

Në krahasim me vitin 2019, gjatë vitit 2020 vërehet një pakësim në total i numrit të procedimeve të regjistruara për veprat penale:

- “Vjedhja” – neni 134 (70 procedime më pak);
- “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” parashikuar nga neni 291 i K.Penal (16 procedime më pak),
- “Dhuna në familje” e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal (28 procedime më pak);
- “Ndërtimi i paligjshëm” parashikuar nga neni 199/a i K.Penal (39 procedime më pak),
- “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor” e parashikuar nga neni 290 i K.Penal (7 procedime më pak);

Nga analizimi i treguesve për grup veprave të veçanta, ndjeka penale e të cilave është përcaktuar edhe si prioritare në “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave” të miratuara me vendimin Nr.501 date 24.06.2020, në luftë kundër kriminalitetit për vitin 2020 rezultatet paraqiten si mëposhtë:

**1-** Gjatë vitit 2020 numri i procedimeve të regjistruara për veprën penale “Kultivimi i bimëve narkotike” i parashikuar nga neni 284 i K.Penal, është shumë i vogël, vetëm 2 (dy), ndërsa e vetmja vepër penale e cila ka një rritje shumë të vogël, me 6 procedime më shumë për veprën penale të parashikuar nga neni 283 “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve”.

**2-** Në mënyrë më të detajuar të dhenat e vitit 2020 për veprën penale të parashikuar nga neni 283 “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” paraqiten të tilla:

Është punuar në fazën hetimore në 50 procedime penale të regjistruara për veprën penale të “Prodhimi dhe shitja e narkotikëve” parashikuar nga neni 283 i K.Penal.

Nga ky numër, 20 procedime penal janë të mbartura nga viti 2019 dhe 30 procedime të regjistruara rishtazi.

Nga këto procedime janë dërguar në gjyq 9 (nëntë) prej tyre, për 9 procedime të tjera është kërkuar pushimi i hetimeve, 2 (dy) janë pezulluar ndërsa çështjet e tjera janë në hetim. Për të gjitha këto procedime kanë filluar edhe verifikimet pasurore në zbatim të ligjit Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar.

Për 9 procedime penal për të cilat është kërkuar dhe vendosur pushimi i hetimeve dhe shkak i ligjor ka qënë se, personat janë kapur më doza të vogla të cilat pas hetimeve kanë rezultuar për përdorim vetjak

**3-** Gjatë vitit 2020 janë hetuar 30 (tridhjetë) procedime për veprën penale “Pastrimit të produkteve të veprës penale” vepër e parashikuar nga neni 287 i K.Penal.

Nga totali prej 30 procedimesh, 9 (nëntë) procedime janë të mbartura nga viti 2019, ndërsa 27 procedime penal janë të regjistruara rishtazi, gjithashtu janë dhe 4 procedime të rifilluara. Në asnjë nga këto procedime penale, nuk ka pasur asnjë kërkesë për vendosje sekuestro apo konfiskim në kuadër të hetimeve për këtë vepër penale gjatë këtij viti.

4- Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë në vitin 2020 ka regjistruar 2 procedime penale për veprën penale “Vrasja me dashje” e parashikuar nga neni 76 i K.Penal.

Pasi hetimeve të kryera për këto procedime është kërkuar pushimi i hetimeve në Gjykatë, pasi vdekjet e dyshimta kanë rezultuar të kenë ndodhur për shkaqe aksidentale dhe natyrore dhe jo nga veprime të paligjshme.

Ndërsa 2 (dy) procedimet penale të regjistruara për veprën penale “Vrasja me dashje” e mbetur në tentative, vepër e parashikuar nga neni 76 e 22 i K.Penal janë dërguar për gjykim.

E dhëna më pozitive e këtyre treguesve është fakti se: Gjatë vitit 2020 në territorin e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë nuk ka ndodhur asnjë vrasje.

5- Gjatë vitit 2020 Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë ka kryer hetime për 30 procedime penale të regjistruar për kryerjen e veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës” vepër e parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

Nga këto procedime penale 7 procedime penale janë regjistruar në vitin 2020 ndërsa 23 procedime penale janë mbartur nga viti 2019.

Për 10 procedime penal për të cilat është kërkuar dhe vendosur pushimi i hetimeve dhe shkaku ligjor është “*për mungesë fakti*” ku përfshihen si rastet kur është konstatuar se fakti nuk ekziston ashtu edhe ato kur fakti nuk përbën vepër penale.

Aktualisht janë në hetim 20 procedime penale për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës” vepër e parashikuar nga neni 248 i K.Penal.

6- Për veprën penale të “Dhunës në familje” vepër e parashikuar nga neni 130/a i K.Penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë ka kryer hetime për 78 procedime penale nga të cilat 22 procedime penale janë mbartur nga viti 2019 ndërsa 56 janë procedime të regjistruara gjatë vitit 2020.

Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë ka përfunduar hetimet për 48 procedime penale ku për 43 procedime penale ka kërkuar gjykimin dhe për 5 procedime pushimin e hetimeve.

7- Gjithashtu gjatë vitit 2020, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë ka kryer hetime për 6 procedime penale për vepra penale në fushën e taksave dhe tatimeve nga të cilat 4 procedime penale janë mbartur nga viti 2019 ndërsa 2 janë procedime të regjistruara gjatë vitit 2020.

Aktualisht të gjithë këto procedime janë në fazën e hetimit.

Pjesa më e madhe e kallëzimeve penale të referuar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë vijnë nga Komisariati i Policisë Lushnje, Komisariati i Policisë Divjakë dhe Drejtoria Vendore e Policisë Fier në total 1221, kurse pjesa tjetër janë kallëzime nga shtetasit (59), nga Drejtoria e Hetimit Tatimor (2), SH.Ç.B.A (2), Administrata e Zonave të Mbrojtura (1) dhe institucione të ndryshme (13).

Nga Prokuroria e Përgjithshme gjatë vitit 2020 nuk janë përcjellë për hetim çështje që lidhen me procesin e verifikimit të integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike.

Edhe Kontrolli i Lartë i Shtetit gjatë vitit 2020 nuk është dërguar asnjë kallëzim ndërsa procedimi penal i regjistruar në bazë të indicieve të dërguara në vitin 2019 nga ky institucion (për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” të parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal), është ende në hetim.


Në fazën e hetimit paraprak paraqiten këto të dhëna.

### HETIMI

|      | Procedime të përfunduara | Dërguar në gjyq | Pushuar | Pezulluar | Transferuar | Të pandehur | Persona nën hetim | Arrest në burg | Mbartur | Persona nën hetim | Arrest në burg |
|------|--------------------------|-----------------|---------|-----------|-------------|-------------|-------------------|----------------|---------|-------------------|----------------|
| 2018 | 860                      | 320             | 127     | 383       | 29          | 377         | 86                | 71             | 222     | 69                | 15             |
| 2019 | 793                      | 320             | 102     | 351       | 20          | 339         | 51                | 53             | 315     | 118               | 22             |
| 2020 | 657                      | 280             | 123     | 246       | 8           | 295         | 58                | 47             | 397     | 137               | 28             |

7.

*Më poshtë paraqitet grafikisht krahasimi mes numrit të çështjeve të përfunduara gjatë viteve 2018, 2019 dhe 2020 sipas mënyrës së përfundimit:*



## PROCEDIMET E DËRGUARA PËR GJYKIM

Në vitin 2020 është kërkuar dërgimi për gjykim, miratimi i urdhërit penal dhe i marrëveshjeve të fajësisë për **280** procedime penale me 295 të pandehur nga të cilët 47 nën masën e sigurisë “Arrest në burg”.

Këto procedime zënë rreth 42,6% të numrit të përgjithshëm të procedimeve penale të përfunduara (Ilogaritja është bërë duke marrë në konsideratë të gjitha çështjet e përfunduara: dërguar gjyqit+të pushuara+të pezulluara+të transferuara).

Pra, rezulton se megjithëse një numër më të vogël procedimesh penale të regjistruara në vitin 2020, përqindja e procedimeve të dërguara për gjykim në vitin 2020 në raport me totalin e procedimeve të përfunduara është 2,2% më e lartë se në vitin 2019.

Gjatë vitit 2020 është kërkuar në gjykatë gjykimi i drejtpërdrejtë vetëm në 4 (katër) raste të pranuar edhe nga gjykata.

| Miratim urdhëri penal |             | Vendimi i gjykatës |                |                                | Marrëveshje fajësie |             | Vendimi i gjykatës  |                |                                   |
|-----------------------|-------------|--------------------|----------------|--------------------------------|---------------------|-------------|---------------------|----------------|-----------------------------------|
| Çështje               | Të Pandehur | Miratim urdhëri    | Pushim çështje | Refuzim urdhëri e kthim aktesh | Çështje             | Të Pandehur | Miratim marrëveshje | Pushim çështje | Refuzim marrëveshje, kthim aktesh |
| -                     | -           | -                  | -              | -                              | 1                   | 1           | 1                   | -              | -                                 |

| Kërkesë për dërgim në gjyq |             | Vendimi i gjykatës |                           |              |                               | Mbartur në gjykim |
|----------------------------|-------------|--------------------|---------------------------|--------------|-------------------------------|-------------------|
| Çështje                    | Të Pandehur | Pranim kërkesë     | Pushimi çështje ose akuze | Kthim aktesh | Dërgim në gjykatën kompetente |                   |
| 275                        | 291         | 227                | 2                         | 3            | -                             | 43                |

Siç shihet, treguesit e çështjeve të dërguara në gjyq janë në parametra pozitivë duke ju përmbajtur gjithmonë parimit për të dërguar në gjyq ato procedime për të cilat ka pasur një bazë të mjaftueshme të dhënash hetimore për provueshmërinë e akuzës në ngarkim të personave të pandehur. Nga procedimet e dërguara për gjykim pjesën kryesore e zënë procedimet e regjistruara mbi bazën e materialeve të referuara nga organet e Policisë së Shtetit si dhe nga qytetarët.

Seksionit për të Miturit ka dërguar në gjyq 4 (katër) procedime penale me 5 (pesë) të mitur në konflikt me ligjin, ku për 3 prej të cilëve gjykata ka pranuar kërkesën për dërgimin në gjyq dhe një procedim është ende duke u shqyrtuar. Për asnjë prej këtyre procedimeve nuk ka përfunduar gjykimi në themel.

Numrin më të madh të procedimeve për të cilët është kërkuar dërgimi në gjyq e zënë ata të regjistruar për veprat penale “Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt” – neni 291



i K.Penal, 106, "Dhuna në familje"- neni 130/a, 43, "Ndërtimi i paligjshëm"- neni 199/a i K.Penal, 33.

Mbetet ende shumë i vogël numri i kërkesave për dërgim në gjyq të procedimeve penale të regjistruara për veprën penale "Vjedhja" e parashikuar nga neni 134 i K.Penal, megjithëse përbën veprën penale më të përhapur në territorin e Prokurorisë Lushnjë.

Nga analizimi i bërë këtij këtij fenomeni me drejtuesit e Komisarariatit të Policisë Lushnje e Divjakë, duke ju referuar menyrave të veprimit të autorëve, kohës së veprimit, sendeve të vjedhura, personalitetit të personave të identifikuar e dënuar nga Gjykata si autor të veprës penale të "Vjedhjes" na ka rezultuar se:

Në pjesën më të madhe të rasteve autorët e kësaj veprë penale nuk janë banorë të qytetit të Lushnjës fakti i cili bën shumë të vështirë identifikimin dhe goditjen e tyre pasi aktiviteti i tyre në rrethin e Lushnjës është vetëm në kryerjen e veprës penale e mëpas largohen duke mos lënë asnjë gjurmë që mund të shërbej për identifikimin e tyre.

Ky konstatim mbështetet në disa të dhënat e konkretisht:

Referuar autorëve të identifikuar të kësaj veprë penale të cilët në pjesën më të madhe nuk janë banorë të Lushnjës apo Divjakës.

Kohës së veprimit dhe sendeve të vjedhura siç është p.sh muaji Dhjetor ku tendenca është për vjedhje në zonat rurale të shpezeve apo blegtorisë që rritin fshatarët për festat e fund vitit apo muajt Korrik-Gusht perjudha që përkon me ardhjen e emigrantëve ku rritet numri i vjedhjeve të automjeteve apo sendeve brënda automjeteve apo dhe muajt Janar e Shtator ku rritet numri i vjedhjeve në banes e cila përkon me perjudhën ku emigrantët largohen.

Gjithashtu edhe perjudha e pandemisë, ku mbajtja e maskës dhe dorezave është detyrim ligjor, ka kontribuar që autorët e këtyre veprave penale të jënë në kushte të favorshme për kryerjen e veprës penale

Në këto analiza janë marrë në shqyrtim edhe mënyrat se si ne, si organe ligjzbatuese duhet ti përgjigjen këtij fenomeni.

Për t'ju përgjigjur në mënyrë sa më efektive këtij fenomeni strukturat e policisë do të rrisin bashkëpunimin me organet e qeverisjes vëndorë si dhe brënda kapaciteteve që kanë do të shtojnë prezencën policorë në zonat të cilat sipas perjudhave të caktuara kanë edhe riskun më të madh për tu goditur nga autorët e veprës penale.

Në përgjigje të shqetësimeve tona dhe në frymën e bashkëpunimit, Bashkia Lushnje ka filluar projektin e monitorimit të akteve kryesore të qytetit me kamera sigurie, fakt i cili ka rritur parametrat e sigurisë në qytet.

### **TË DHËNA TË PËRGJITHËSHME MBI TË PANDEHURIT**

Nga 295 të pandehur që janë regjistruar në vitin 2020, 282 kanë qenë meshkuj dhe 13 femra, të gjithë shtetas shqiptarë. Sa i përket arsimimit, pjesa më e madhe janë me arsim 9-vjeçar 193 persona, kundrejt 89 personave me arsim të mesëm dhe 13 personave me arsim të lartë.

Në pjesën më të madhe të tyre (192 persona), të pandehurit janë të punësuar në sektorin privat, kryesisht të vetpunësuar në bujqësi, 95 kanë qenë të papunë, 5 (pesë) kanë qenë nëpunës dhe 3 (tre) kanë qenë punonjës policie. Për sa i përket gjendjes gjyqësore të tyre, 265 të

pandehur (nga 295) kanë qenë të padënuar (duke përfshirë edhe të rehabilituarit), ndërsa 30 përsëritës nga të cilët 14 përsëritës të posaçëm.

Mungesa e urdhërave penale dhe numri i vogël i marrëveshjeve të fajësisë, vetëm 1 (një), në raport me numrin e përgjithshëm të procedimeve të dërguara në gjyq 280, vjen si pasojë e përvojave negative që ka pasur Prokuroria Lushnjë me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë fill pas ndryshimeve në Kodin e Procedurës Penale. Gjykata në pjesën më të konsiderueshme të rasteve ka vendosur refuzimin e urdhërave penale dhe marrëveshjeve të fajësisë, çka ka sjellë që prokurorët të preferojnë të procedojnë me kërkesa për dërgim në gjyq nisur nga parimi i përfundimit të hetimeve dhe gjykimeve brenda një afati të arsyeshëm kohor konform nenit 6 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut.

**PROCEDIMET PENALE TË PUSHUARA DHE PËR TË CILAT ËSHTË KËRKUAR  
PUSHIMI**

|                       | Gjithsej | Mungesë fakti | Mungesë prove | Shkaqe të tjera | Persona nën hetim |               |                 |                |
|-----------------------|----------|---------------|---------------|-----------------|-------------------|---------------|-----------------|----------------|
|                       |          |               |               |                 | Mungesë fakti     | Mungesë prove | Shkaqe të tjera | Arrest në burg |
| Procedime të pushuara | 123      | 87            | 13            | 23              | 35                | 4             | 13              | -              |

Referuar nenit 329/a të Kodit të Procedurës Penale gjatë vitit 2020 për procedimet penale të regjistruara për krime kemi pasur këto rezultate:

| DËRGUAR GJYKATËS PËR PUSHIM<br>ÇËSHTJE OSE AKUZE |                   |             | VENDIMI I GJYKATËS       |                                 |                                 |                |
|--|-------------------|-------------|--------------------------|---------------------------------|---------------------------------|----------------|
| Çështje  | Persona nën hetim | Të Pandehur | Pushim çështje ose akuze | Kthim aktesh dhe vazhdim hetimi | Kthim aktesh dhe formulim akuze | Pa u shqyrtuar |
| 91   | 41                | -           | 52                       | 14                              | -                               | 25             |

Nga 123 procedime penale të pushuara, 8 (tetë) prej tyre janë procedime penale me të mitur në konflikt me ligjin, të cilët janë pushuar duke zbatuar shmangien dhe masën alternative të paralajmërimit me shkrim në 7 (shtatë) raste dhe paralajmërimin me gojë në 1 (një) rast.

Çështjet e pushuara zënë rreth 18,7% të numrit të përgjithshëm të çështjeve të përfunduara në periudhën 1 vjeçare, me një rritje prej rreth 5,9 % nga viti i kaluar.

Numri më i madh i çështjeve të pushuara është “*për mungesë fakti*” ku përfshihen si rastet kur është konstatuar se fakti nuk ekziston ashtu edhe ato kur fakti nuk përbën veprën penale.

Duke analizuar procedimet e pushuara për mungesë të faktit dhe të elementëve të veprës penale, konstatohet se është i nevojshëm një verifikim paraprak dhe një vlerësim më i drejtë i fakteve të paraqitura në materialin kallëzues, por në kushtet kur neni 291 i K.Pr.Penale (ndryshuar me Ligjin Nr.35/2017 datë 30.03.2017) parashikon që prokurori ka vetëm 15 ditë afat nga data e regjistrimit të kallëzimit për të marrë një vendim lidhur me të, për çështjet që paraqiten të komplikuar ky afat është i pamjaftueshëm për të marrë një vendim, prandaj procedohet me regjistrimin e tij si procedim penal dhe në përfundim të hetimeve vendoset ose kërkohet pushimi i hetimeve nëse jemi para rasteve të parashikuara nga neni 328 i K.Pr.Penale.

Çështjet e pushuara për mungesë të provave zënë vetëm 10,5% të numrit të çështjeve të pushuara çka tregon për përpjekjet e bëra për të provuar akuzat në ngarkim të personave ndaj të cilëve ushtrohet ndjekje penale.

Ndër çështjet e pushuara “*për shkaqe të tjera procedurale*” vendin kryesor e zënë ato që kanë të bëjnë me heqjen dorë nga ankimi prej të dëmtuarve për ato procedime ku ndjekja penale është e kushtëzuar nga vullneti i tij.

Por në këto tregues vërehet se kemi një numër të madh procedimesh penale, 14 procedime, në të cilat Gjykata nuk ka pranuar kërkesat e Prokurorëve për pushimin e procedimit penal por ka vendosur këthimin e akteve në Prokurori dhe vazhdimin e hetimeve.

Nga ana jonë janë marrë në analizë të gjitha këto raste duke përcaktuar sipas vlersimit tonë edhe shkaqet e kësaj vendimmarrje të gjykatës.

Nga këto rastë vërehet se, jo gjithmonë nga ana e Prokurorit dhe Oficerit të Policisë Gjyqësore janë kryer hetime shteruese rreth faktit penal.

Por në shumë raste të tjera vërehet se vendimmarrja e Gjykatës vjen edhe për shkak të mos njohjes së hetimit penal, duke urdhëruar për detyra të karakterit formal ose objektivisht të pamundura që nuk kanë asnjë ndikim mbi thelbin e çështjes.

### **PROCEDIMET PENALE TE PEZULLUARA**

Gjatë vitit 2020 janë pezulluar **246** procedime penale ose 37.4% e çështjeve të përfunduara, 7% më pak se viti 2019. Numrin më të madh të procedimeve penale të pezulluara e zënë procedimet për veprën penale të “Vjedhjes” (neni 134 i K.Penal).

Është synuar që vendimet e pezullimit të merren pasi të jenë kryer të gjitha veprimet e mundshme hetimore duke i kushtuar rëndësi të veçantë kryerjes së veprimeve në vendin e ngjarjes, fiksimit të provave në formën e parashikuar në ligj, etj.

Është e nevojshme që prokurori gjatë hetimeve paraprake të jetë më shumë drejtues dhe kontrollues, duke qenë me afër policisë në ngjarjet e rënda kriminale, por dhe duke kontrolluar në vazhdimësi ligjshmërinë e kryerjes së veprimeve hetimore nga ana e tyre.

Këtë vit janë rifilluar hetimet për 8 procedime të viteve të mëparshme, 4 prej të cilave kanë qenë të pushuara dhe 4 kanë qenë të pezulluara për moszbulim autori.

### **MOSFILLIMET**

Në vitin 2020 është vendosur mosfillimi për **579** kallëzime penale ose për 124 kallëzime më pak se viti 2019. Për të gjitha këto raste është treguar kujdesi i duhur që vendimi të merret pasi të jenë kryer verifikimet e nevojshme dhe brenda afatit të përcaktuar në Kodin e Procedurës Penale.

Gjatë vitit 2020 ka pasur 9 (nëntë) vendime mosfillimi procedimi penal për të mitur në konflikt me ligjin.

Përgjithësisht është respektuar ky afat me përjashtim të disa rasteve kur vonesat kanë ardhur për shkaqe objektive, siç është rasti i vonesave të akteve të ekspertimit, kryesisht mjekoligjore, por në raste të veçanta edhe për neglizhencë nga oficerët e policisë gjyqësore të ngarkuar për të kryer verifikimet apo edhe nga vetë prokurorët. Mendojmë se politika e ndjekur në rastet e vendimeve të mosfillimit ka shërbyer jo vetëm për të mos harxhuar energji të panevojshme, por edhe për të parandaluar fillimin e ndjekjes penale ndaj personave të cilët në fakt nuk dyshohen të kenë kryer ndonjë vepër penale. Në zbatim të detyrimeve të ligjit procedural penal të gjithë personave të interesuar u janë komunikuar vendimet e mosfillimit duke u dhënë atyre mundësinë për të ushtruar të drejtën e ankimit në Gjykatë.

Nga procedimet penale të mosfilluara janë ankimuar në Gjykatë 17 prej tyre. Gjykata ka lënë në fuqi vendimet e mosfillimit në 7 raste, ka pranuar ankimin në 9 raste, ndërsa ankimi tjetër është ende duke u shqyrtuar.

### **MASAT E SIGURIMIT**

| Arrest në flagrancë | Ndalime nga Pol. Gjyqësore | Urdhër ndalimi të Prokurorit | Gjithsej | Urdhër lirim të menjëhershëm | Kërkesa për vlerësim | Vlerësime të ligjshme | Vlerësime të paligjshme |
|---------------------|----------------------------|------------------------------|----------|------------------------------|----------------------|-----------------------|-------------------------|
| 147                 | 8                          | 2                            | 157      | 1                            | 156                  | 155                   | 1                       |

Për këta tregues është kërkuar respektimi me korrektësi i kriterëve të përcaktuara në ligjin procedural penal si dhe garantimi i të drejtave të personave që u është hequr liria. Në

analizën e treguesve bie në sy fakti që vetëm në 1 rast nga 156 gjithsej është vlerësuar i paligjshëm nga Gjykata e Shkallës së Parë.

Lidhur me zbatimin e masave të sigurimit personal ndaj të miturve në konflikt me ligjin, nuk ka pasur asnjë rast caktimi mase sigurimi personal.

### Masat e sigurimit

|          | Arrest në burg | Arrest në burg në mungesë | Arrest në shtëpi | Arrest në burg me afat | Garanci pasurore | Detyrim për paraqitje | Masa ndaluese |
|----------|----------------|---------------------------|------------------|------------------------|------------------|-----------------------|---------------|
| Kërkuar  | 54             | 7                         | 2                | 2                      | -                | 91                    | 7             |
| Vendosur | 50             | 6                         | 4                | 2                      | -                | 93                    | 8             |

Gjatë vitit 2020 nuk janë caktuar masa sigurimi ndaj të miturve në konflikt me ligjin.

### Apelet ndaj masave të sigurimit


| Apel            | Gjithsej | Zgjidhja nga Gjykata e Apelit Vlorë |                           |                          |                          |                                |
|-----------------|----------|-------------------------------------|---------------------------|--------------------------|--------------------------|--------------------------------|
|                 |          | Shfuqizim Vendimi                   | Nd/Vend. Sipas Apel/Prok. | Nd/Vend M.Sig më të Butë | Mirat. Vend që Pran.K/Pr | Mirat. Vend që Rrëzon.K/P rok. |
| Nga Prokuroria  | 2        | -                                   | -                         | 2                        | 8                        | 1                              |
| Nga i Pandehuri | 18       |                                     |                           |                          |                          |                                |

### GJYKIMI

|           | Mbartur në gjykim | Dërguar në gjyq | Të pandehur | Arrest në burg | Përfunduar gjykimi | Të pandehur | Arrest në burg | Gjykim i drejtpërdrejtë | Gjykim i shkurtuar | Gjykim i zakonshëm | Mbarten në gjykim | Të pandehur | Arrest në burg |
|-----------|-------------------|-----------------|-------------|----------------|--------------------|-------------|----------------|-------------------------|--------------------|--------------------|-------------------|-------------|----------------|
| Viti 2020 | 175               | 280             | 511         | 71             | 283                | 315         | 40             | 4                       | 251                | 31                 | 172               | 196         | 31             |

|                      | <i>Kërkuar nga Prokuroria</i> | <i>Vendosur nga Gjykata</i> |
|----------------------|-------------------------------|-----------------------------|
| Burgim               | 104                           | 71                          |
| Gjobë                | 35                            | 62                          |
| Pezullim (59,63 K.P) | 173                           | 174                         |
| Kthim akte           | -                             | 1                           |
| Pushimi i akuzës     | -                             | -                           |
| Pushimi i çështjes   | 3                             | 5                           |
| Pafajësi             | -                             | 2                           |

Më poshtë paraqiten grafikisht llojet e dënimeve të kërkuara nga prokurorët dhe mënyra se si ka vendosur gjykata.



Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnjë i ka aplikuar gjerësisht dënimet alternative (pasi janë plotësuar kriteret ligjore): është kërkuar aplikimi i neneve 59 dhe 63 të K.Penal në 173 raste kundrejt 104 kërkesave për dënim me burgim.

Në vitin 2020 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnje është dhënë pafajësi në 2 procedime (me 2 të pandehur). Në të dy rastet të pandehurit kanë qenë pa masë sigurimi personal.

Në krahasim me vitin 2019 numri i procedimeve për të cilat është dhënë pafajësi është më i vogël 2 procedime në vitin 2020 nga 4 procedime që ishte në vitin 2019 .

Më konkretisht, janë deklaruar të pafajshëm të pandehurit:

1. X.X, hetuar në gjendje të lirë, i akuzuar për veprat penale “Dhuna në familje” dhe “Veprime në kundërshtim me vendimin e gjykatës” të

parashikuara nga nenet 130/a/2 dhe 321/2 të Kodit Penal, procedim i cili është dërguar për gjykim nga prokurori Skënder Mestani.

2. X.X., hetuar në gjendje të lirë, i akuzuar për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës” parashikuar nga neni 248 i K.Penal, procedim i cili është dërguar për gjykim nga prokurorja Natasha Prifti.

Këto vendime janë ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, por nuk ka përfunduar gjykimi. Pas përfundimit të gjyimit në Apel të gjitha këto raste do t’u nënshtrohen analizave për të përcaktuar edhe përgjegjësitë përkatëse të secilit prokuror.

Gjithsesi, ky tregues, pavarësisht pretendimeve që kemi për bazueshmërinë e vendimeve të gjykatës, duhet të merret në konsideratë për të bërë kujdes në sigurimin e provave në hetimin paraprak, por edhe për rritjen e rolit të prokurorit gjatë shqyrtimit gjyqësor, sidomos në fazën e administrimit të provave.

Për fazën e gjyimit i është kushtuar rëndësi sigurimit të provave të mjaftueshme për të vërtetuar fajësinë e të pandehurve si dhe diferencimit të llojit dhe masës së dënimit në varësi të veprës penale të kryer.

Për veprat penale me rrezikshmëri të theksuar shoqërore, si ato kundër jetës dhe shëndetit, vjedhjet, mashtrimet, shkeljet e rregullave të qarkullimit rrugor, veprat penale në fushën e narkotikëve, etj. kërkesat tona për llojin dhe masën e dënimit kanë qenë të tilla që t’i shërbejnë parandalimit dhe ndëshkimit të këtyre veprave penale.

Gjithsesi, duke analizuar gjithë treguesit e këtij viti mendojmë se është e nevojshme që politika e dënimit të përmirësohet në vijimësi duke e bërë më fleksibël dhe duke e përshtatur me format dhe tendencat e kriminalitetit në rrethin tonë.

Gjatë vitit 2020 kanë qenë 3 raste kur prokurorët kanë apeluar vendimin e Gjykatës.

### **EKZEKUTIMI I VENDIMEVE PENALE**

Prokuroria e pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje gjatë vitit 2020 ka kryer edhe detyrimet procedurale në fushën e ekzekutimit të vendimeve penale. Gjatë vitit 2020, siç u citua edhe më sipër, të ngarkuar me këtë detyrë kanë qenë prokurorët **Artan Hazbi** dhe **Merita Selimi**.

|          |               |                |                   |              |              |            |           |
|----------|---------------|----------------|-------------------|--------------|--------------|------------|-----------|
| Vendi me | Dënim me burg | Dënim me gjobë | Dënime plotësuese | Neni 59 K.P. | Neni 63 K.P. | Masa miale | Shpenzime |
|----------|---------------|----------------|-------------------|--------------|--------------|------------|-----------|

|     |        |            |        |            |        |            |        |            |        |            |    |     |
|-----|--------|------------|--------|------------|--------|------------|--------|------------|--------|------------|----|-----|
|     | Urdhra | Ekzekutuar | Urdhra | Ekzekutuar | Urdhra | Ekzekutuar | Urdhra | Ekzekutuar | Urdhra | Ekzekutuar |    |     |
| 389 | 52     | 42         | 45     | 28         | 55     | 50         | 174    | 63         | 19     | 15         | 41 | 282 |

Problem mbetet ende ekzekutimi i dënimeve me gjobë, në ndonjë rast edhe për moskryerje të detyrës nga organet përmbarimore.

Niveli i ulët në ekzekutimin e vendimeve të pezullimit të dënimit dhe vënien e të dënuarve në provë sipas nenit 59 të K.Penal, ka ardhur për shkak të afateve të gjata të kohës së vënies në provë të vendosura nga gjykatat, por edhe nga mosmarrja dijeni rregullisht prej të dënuarve për detyrimin për t'u paraqitur pranë Zyrës Vendore të Shërbimit të Provës.

Gjithashtu janë ndjekur rregullisht në gjykatë edhe ankimet e të dënuarve gjatë fazës së ekzekutimeve.

### ***Marrëdhëniet juridiksionale me jashtë***

Gjatë vitit 2020 është trajtuar vetëm 1 (një) kërkesë për ekstradim jashtë Shqipërisë, e cila është pranuar nga Gjykata, ndërkohë nuk ka pasur kërkesë për njohje vendimi penal të huaj.

***Ligji Nr.10192, datë 03.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjera nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, i ndryshuar***

Gjatë vitit 2020 janë shqyrtuar 28 hetime pasurore, nga të cilat 23 janë mbartur nga viti 2019 dhe 5 janë regjistruar të reja, si dhe 5 hetime financiare.

Në zbatim të Udhëzimit të Përgjithshëm Nr.10, datë 17.07.2020 të Prokurorit të Përgjithshëm nga Drejtuesi i Prokurorisë janë caktuar prokurorja Rovena Zoto dhe o.p.gj. Irma Velo për të ndjekur grupveprat penale kundër pastrimit të parave, financimit të terrorizmit, krimeve financiare dhe hetimeve pasurore.

Asnjë prej këtyre hetimeve nuk është përfunduar pasi përveç kompleksitetit që paraqesin, që prej hyrjes në fuqi të VKM Nr.389, datë 13.05.2020, Prokuroria nuk mund t'u drejtojë më kërkesa Drejtorive Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës. Ky V.K.M. kërkon detyrimisht dërgimin e kërkesave online ç'ka ka rezultuar i pamundur për shkak se Prokuroria nuk mund të regjistrohet si biznes në portalin e-albania (sipas udhëzimit të ASHK-së).



Nga aksesit në databazën e ASHK-së që na u vu në dispozicion në muajin Nëntor të vitit 2020 merret një informacion i pjesshëm, vetëm për pasuritë e regjistruara në emër të personave që janë objekt verifikimi (edhe ky jo i plotë pasi mungojnë qytetet/rrethet), por nuk mund të shkarkohen dokumentet në bazë të të cilave janë bërë këto regjistrime, që do të tregonin origjinën e kësaj pronësie. Edhe për vetëdeklarimet për legalizim është i njëjti problem.

Duke mos qenë i mundur administrimi i praktikave shkresore të regjistrimit të pasurive, hetimet nuk mund të quhen të plota dhe për rrjedhojë ato nuk mund të përfundojnë.

### **TREGUESIT E PUNËS PËR VITIN 2020**

Procedimet penale dhe materialet referuese që janë hetuar nga secili prej prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore gjatë vitit 2020, janë si më poshtë:

| Prokurori                        | Procedime penale të hetuara | Dërguar në gjyq | Pushuar    | Pezulluar  | Shpallur moskompetenca | Mosfillime | Mbartur    |
|----------------------------------|-----------------------------|-----------------|------------|------------|------------------------|------------|------------|
| <b>Arben Dyla</b>                | 11                          | -               | 8          | 1          | -                      | -          | 2          |
| <b>Merita Selimi</b>             | 193                         | 63              | 29         | 45         | 2                      | 98         | 54         |
| <b>Skënder Mestani</b>           | 225                         | 55              | 20         | 39         | -                      | 99         | 111        |
| <b>Artan Hazbi</b>               | 197                         | 43              | 11         | 55         | 1                      | 131        | 87         |
| <b>Natasha (Shallapi) Prifti</b> | 252                         | 70              | 34         | 52         | 3                      | 148        | 93         |
| <b>Rovena (Bozo) Zoto</b>        | 176                         | 49              | 21         | 54         | 2                      | 103        | 50         |
| <b>Totali</b>                    | <b>1054</b>                 | <b>280</b>      | <b>123</b> | <b>246</b> | <b>8</b>               | <b>579</b> | <b>397</b> |

Duhet të evidentojmë se prokurorët Artan Hazbi dhe Merita Selimi krahas hetimit kanë qenë të ngarkuar edhe me ekzekutimin e vendimeve penale, përkatësisht nga 6 (gjashtë) muaj secili.

### **Oficerët e Policisë Gjyqësore**

|                   | Procedime të hetuara | Dërguar në gjyq | Pushuar | Pezulluar | Transferuar | Mosfillim | Mbartur | Hetime Ligji Antimafia |
|-------------------|----------------------|-----------------|---------|-----------|-------------|-----------|---------|------------------------|
| Irma Velo         | 98                   | 29              | 20      | 10        | 1           | 17        | 38      | 33                     |
| Brixhilda Sinjari | 62                   | 22              | 7       | 0         | 0           | 0         | 33      |                        |
| Lazar Tuni        | 57                   | 10              | 13      | 3         | 0           | 0         | 31      |                        |

## **VEPRIMTARIA ADMINISTRATIVE**

### **Drejtuesi i Prokurorisë:**

Është përpjekur të përmirësojë organizimin e brendshëm të punës dhe disiplinën e punës në Prokurori me qëllim rritjen e kontrollit ndaj punës së prokurorëve për procedimet penale që ata kanë në hetim dhe gjykim, por edhe duke marrë pjesë vetë që në momentet e para për ngjarjet e rënda kriminale. Në këtë kuadër i ka kushtuar një kujdes të veçantë trajtimit të të gjitha materialeve kallëzuese, regjistrimit të procedimeve penale, shpërndarjes së një ngarkese uniforme për të gjithë prokurorët, kontrollit gjatë fazës së hetimeve.

Gjatë vitit 2020 për shpërndarjen e çështjeve është proceduar me shortin elektronik të sistemit CAMS.

Gjithashtu në fokusin e punës së Drejtuesit të Prokurorisë ka qënë edhe vënia në zbatim e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020, “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave” të miratuara me vendimin Nr.501 date 24.06.2020, në luftë kundër kriminalitetit për vitin 2020 për të cilat Prokurori i Përgjithëshëm ka percjelle në Prokuroritë e Juridiksionit të Përgjithëshëm, Planin e veprimit të miratuar me Urdhërin Nr.103/2020 si dhe Planin e Veprimit të miratuar me Udhërin Nr.112 datë 27.07.2020.

Në lehtësim të palnit të veprimit të Prokurorit të Përgjithëshëm dhe me qëllim venien efektivisht në zbatim të Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020 dhe “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave” të miratuara me vendimin Nr.501 date 24.06.2020, në luftë kundër kriminalitetit për vitin 2020, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Lushnjë është nxjerrë Urdhëri Nr.6 datë 25.09.2020 “Për Miratimin e Planit të Veprimit mbi rekomandimet prioritare të Këshillit të Ministrave në luftën kundër kriminalitetit për vitin 2020 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje si dhe Urdhëri Nr.7 datë 29.09.2020 “Për miratimin e Planit të Veprimit për zbatimin e Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020 në Prokurorinë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje.

Gjithashtu edhe nxjerra e “Udhëzimit të Përgjithëshëm Nr.12 datë 20.07.2020” nga Prokurori i Përgjithëshëm, i cili vendosi disa vija të qarta sjellje në marrdhëniet ndërmjet Drejtuesve të Prokurorive dhe Prokurorëve në lidhe më informimin, transparencën dhe garantimin e pavarsisë së Prokurorëve, ka kontribuar në implementimin më cilësor të Rezolutës së Kuvendit datë 18.06.2020 dhe “Rekomandimeve Prioritare të Këshillit të Ministrave” të miratuara me vendimin Nr.501 date 24.06.2020, në luftë kundër kriminalitetit për vitin 2020.

Në përputhje me “Udhëzimin e Përgjithëshëm Nr.12 datë 20.07.2020” të Prokurorit të Përgjithëshëm si dhe në përmbushjeve të detyrimeve të tij ligjore, nga ana e Drejtuesit të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje për perjudhën 4 (katër) mujore, janë nxjerrë gjithashtu edhe 17 (shtatëmbëdhjetë) “Udhëzime Jo të Detyrueshme” për çështje konkrete.

Në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga Plan i Veprimit i miratuar me Urdhërin Nr.103/2020 si dhe Plani i Veprimit i miratuar me Udhërin Nr.112 datë 27.07.2020 nga Prokurori Përgjithëshëm, Drejtuesi i Prokurorisë Lushnje ka ushtruar kontroll mbi procedimeve penale të regjistruara përpara vitit 2020, të cilat rezultojnë të ishin akoma në hetim, pas përpunimit të të dhënave statistikore të perjudhës 9 (nëntë) mujore të Prokurorisë Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje.

Gjatë vitit 2020 është punuar kryesisht për forcimin e bashkëpunimit me Policinë Gjyqësore pranë komisariateve të policisë Lushnjë e Divjakë dhe Drejtorisë Vendore të Policisë Fier, Drejtorisë së Përgjithëshme të Policisë së Shtetit, por edhe me shërbimet e policisë gjyqësore që funksionojnë në institucionet e tjera, si Hetimi Tatimor, në funksion të përmirësimit të cilësisë së hetimit.

Falë këtij bashkëpunimi të frytshëm, Prokuroria Pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Lushnje në bashkëpunim të ngushtë me Drejtorinë e Përgjithëshme të Policisë së Shtetit, Drejtorinë Vëndore të Policisë Fier dhe Komisariatin e Policisë Lushnje, ka përfunduar veprimet hetimore të procedimit penal Nr.713 të vitit 2017, i cili bën fjalë për vrasjen me armë zjarri më datë 11.10.2017 në orën 18 10 në qytetin e Lushnjes të shtetasve X.X dhe X.X.

Gjithashtu Gjykata e Shkallës së Parë Lushnje me kërkesën e Prokurorisë ka vendosur: Masat e sigurimit shtërnguese të karakterit personal “Arrest në burg” ndaj personave nën hetim Y.Y, Z.Z dhe Ë.Ë, si persona të dyshuar për kryerjen e veprave penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, kryer në bashkëpunim, “Mbajtje pa leje e armëve luftarake dhe municionit”, “Prishjes së qetësisë publike” të parashikuar nga nenet 79/dh e 25, 278 dhe 274 të Kodit Penal, të kryera në kuader të grupit strukturuar kriminal **parashikuar nga neni 333/a K.Penal**

Shpalljen e moskompetencës lëndore për gjykimin e kërkesave lidhur me procedimin penal Nr.713/2017, duke urdhëruar dërgimin e akteve të këtij procedimi penal në **Gjykatën e Posaçme të Shkallës Parë për Korrupsion dhe Krimin e Organizuar**, si gjykata kompetente

Por një problematikë e ndeshur në punën tonë është edhe mungesa e logjistikës dhe njëkohësisht e burimeve njerëzore të disponueshme për kryerjen e veprimeve proaktive. Konkretisht, kur është kërkuar bashkëpunimi qoftë në nivel Komisaritati, qoftë në nivel Drejtorie Policie Vendore, kemi hasur në refuzime të këtyre të fundit për kryerjen e veprimeve hetimore me metoda speciale hetimi e justifikuar me mungesën e logjistikës dhe njëkohësisht të O.P.Gj-ve të trajnuar për këtë qëllim.

Pavarësisht problemeve të mësipërme, oficerët e shërbimeve të policisë gjyqësore në Policinë e Shtetit kanë hetuar rreth 50 % të procedimeve që kanë qenë në hetim në vitin 2020.

Në lidhje me trajnimin e Prokurorëve dhe Oficerëve të Policisë Gjyqësore me fokus rritjen e kapacitetit profesional, prej fillimit të vitit akademik 2020-2021 Shkolla e Magjistraturës ka bërë pjesë të trajnimeve të saj veç prokurorët edhe Oficerët e Policisë Gjyqësore.

Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia e COVID-19, trajnimet si për Prokurorët dhe për Oficerët e Policisë Gjyqësore kanë qenë të pakta dhe vetëm në përfundim të vitit 2020 kur kanë filluar edhe trajnimet online.

Është me vend të theksojmë edhe përkushtimin e treguar nga personeli administrativ i kësaj prokurorie, puna e të cilëve ka qenë mbështetje e rëndësishme për prokurorët dhe oficerët e Policisë Gjyqësore në ushtrim të detyrës së tyre, por edhe për qytetarët të cilëve u janë ofruar shërbime administrative të cilësisë së lartë.

Nga analiza në tërësi e elementëve që u përmendën më lart, për të ardhmen prioritetet tona kryesore do të jenë:

**1.** Vazhdimi i ndjekjes me përparësi të procedimeve penale kundër pasurisë, veprat penale në fushën e krimit ekonomik dhe korrupsionit, abuzimit me detyrën të nëpunësve shtetërorë, veprat penale kundër jetës, shëndetit, kundër rendit dhe sigurisë publike, dhe çdo lloj forme tjetër krimi që konsiderohet shqetësuese për komunitetin ku ushtrojmë detyrën.

**2.** Shtimi i përpjekjeve nga prokurorët për të bërë të mundur rritjen e koeficientit të zbulueshmërisë së veprave penale, përmirësimi i treguesve të pafajësisë, ndryshimit të pamotivuar të cilësimit ligjor të veprave penale, aplikimin e një politike penale të ndëshkimit të fajtoresve që t'u përgjigjet nevojave të një lufte sa më efektive kundër kriminalitetit.

**3.** Rritja e funksionit drejtues dhe kontrollues të prokurorit në hetimet paraprake të kryera nga Shërbimet e Policisë Gjyqësore.

**4.** Rritja e profesionalizmit të prokurorëve dhe ruajtja e një figure morale të pastër jashtë çdo ndikimi.

**DREJTUESI I PROKURORISË**

**ARBEN DYLA**

